



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:185552

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06911705

C.nr.3400/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.P. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku & L.L.C nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të cilën e përfaqëson L.M. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i pagave përcjellëse, vlera e kontestit 3,780.00 euro, jashtë seance, me datë 27.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.P. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar *“që të detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që në emër të kompensimit të pagave përcjellëse, që i takojnë pas pensionimit, të i paguaj shumën e përgjithshme prej 3,780.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë, të gjitha këto në afat prej 5 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Xh.P. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, me datën 24.06.2024, ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagave përcjellëse.

Në padi, i autorizuari i paditësit ka cekur se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës në spitalin e Prizrenit, në pozitën Mjek Specialist dhe është pensionuar me datë 26.01.2024. E paditura Spitali Rajonal ne

Prizren, edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë nr.05-3815, e nënshkruar me 12.06.2018, në mes të palëve në marrëveshje si (Për FSSHK për të Punësuarin: Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe për Qeverinë e Kosovës/Ministri i Shëndetësisë së Ministrisë së Shëndetësisë, konform dispozitave të nenit 17 paragrafi 5, të marrëveshjes së cekur, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës Individuale, nuk ka bërë kompensimin e tre pagave përcjellëse për dalje në pensionim në vlerë të përgjithshme prej 3,780.00 euro. Pasi që e paditura nuk i ka paguar mjetet të cilat ka qenë e obliguar ti paguaj vullnetarisht, paditësi ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon të tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu ka theksuar se paditësi marrëdhënien e punës në SPZ e ka filluar me datë 16.08.2004, deri me datë 01.01.2024, ku është pensionuar dhe pas refuzimit të kërkesës për pagesë në emër të tri pagave, i është drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tij. Kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar nga arsyet si vijon: Paditësi kërkesën e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në nenin 17 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Me dispozitat e nenit 17 paragrafit 5 të këtij neni është parapare që "Kompensimi në rast të pensionimit, i punësuarit në rast të pensionimit, gëzon të drejtën në pagese përcjellëse në lartësi prej tri (3) pagave mujore, që i ka marr për 3 muajt e fundit. Në lidhje me kërkesën për kompensim të 3 pagave përcjellëse në rast të pensionimit e kundërshtojnë në tërësi për arsye se shpërblimi me 3 paga përcjellëse në rast të pensionimit është parapare në Marrëveshjen Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë: 12.06.2021, që do të thotë kjo kërkesë padi është jashtë Marrëveshjes Kolektive Sektoriale. Prandaj duke pasur parasysh që paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 01.01.2024, për shkak të plotësimit të kushtit për pension si dhe duke pasur parasysh që në kohën e pensionimit të paditësit Marrëveshja Kolektive Sektoriale nuk ka qenë në fuqi dhe se nuk ekziston ndonjë dispozite ligjore e veçante që garanton pagesën e 3 pagave përcjellëse për punonjësit pas pensionimit, atëherë për këto arsye ka kërkuar nga Gjykata të refuzoj këtë padi si të pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: Vërtetimin me numër 896, të datës 01.08.2022, Vendimin me numër 7/1, të datës 03.01.2024, Vendimin e datës 21.02.2024, të lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, listën e pagave me numër EM00038442, në emër të këtij paditësit.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 399, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka

çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune, ndërsa i njëjti pensionohet me datë 01.01.2024, fakt që vërtetohet me vendimin numër 7/1, të datës 03.01.2024, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit prej gjashtëdhjetepesë (65) vjet.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Paditësi ka punuar në vendin e punës Gjinekolog, në Repartin e Gjinekologjisë pranë të paditurës deri më datë 01.01.2024, i cili fakt vërtetohet nga vendimin numër 7/1, të datës 03.01.2024, e bazuar në këtë fakt gjykata konstaton se paditësi moshën e pensionimit tek e paditura e ka arritur me datë 01.01.2024, kurse Kontrata Kolektive Sektoriale, e datës 11.06.2018 me numër të njësisë 01, nr. prot.05-3815, nuk ka zbatueshmëri në vitin 2024, pasi që në kuptim të nenit 2 të KKS, ku përcaktohet se: *“ Afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga data e lidhjes se saj...”*. Kontrata është lidhur me datë 11.06.2018, ndërsa duke u bazuar në Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, në pikë V përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021. Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësi në periudhën për të cilën aplikohet kontrata kolektive sektoriale (11.06.2018 - 10.06.2021) nuk ka arritur moshën e pensionimit, kusht i kërkuar sipas nenit 17 paragraf 5, të KKS, për fitimin e pagesës përcjellëse, për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 dhe nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3400/2024, datë 27.02.2025

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.